REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT
Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Nr 245 **Prot.** **Tiranë, më** 01.07**2026**

URDHËR

NR. 39. DATË 01.07 2026

"PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS"

Bazuar në rregulloren " Për Funksionimin e Shërbimit të Transfuzionit të Gjakut" miratuar me urdhër me Nr.320 datë 21.05.2009 të Ministrit të Shëndetësisë, si dhe Ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003 " Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike".

URDHËROJ

1. Miratimin e Kodit të Etikës për Qedrën Kombëtare të Trasfuzionit të Gjakut, bashkëlidhur këtij Urdhëri.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri të gjithë punojsit e QKTGJ.

3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëher.

DREJTOR

Irena SEFERI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Konceptoi:F.Cullhaj
Miratoi:B.Lukaj
Date: 01.07 2026
Nr: 2 Kopje

KODI I ETIKËS
QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT (QKTGJ)
Parimet e praktikës etike në veprimtarinë transfuzionale

1. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, QKTGJakut angazhohet të garantojë sigurinë, cilësinë, mjaftueshmërin dhe aksesueshmërinë e gjakut dhe komponetëve të tij, duke vepruar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, integritetit dhe përgjeshmëris instituconale.
2. Institucioni është i vetëdijshme se sjellja etike përbën një vlerë dhe kusht thelbësor për përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij dhe se parime të tilla si ndershmëria, integriteti moral dhe profesional, transparenca, besueshmëria dhe përgjegjësia përfaqësojnë themelin e të gjithë aktiviteteve që karakterizojnë misionin e tij, nëpërmjet Kodit të Sjelljes dhe Etikës, synon të përcaktojë rregulla të sjelljes, të cilat përfshijnë zbatimin dhe respektimin e këtyre parimeve në të gjitha ndërveprimet.
3. Shërbimi transfuzional ofrohet duke respektuar të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin dhe integritetin e individit, duke siguruar trajtim të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë.
4. Kodi i Etikës i QKTGJ-së është një përmbledhje tërësore e vlerave dhe parimeve dhe standarteve të sjelljes profesionale që duhet të udhëheqin veprimtarinë e përditshme të punonjësve.
5. Kodi synon të sigurojë standarte të larta profesionalizmi dhe itegriteti, duke parandaluar çdo veprim ose sjellje që bie ndesh me legjislacionin në fuqi, interesin publik dhe parimete e etikës administrative.
6. Subjektet e këtij kodi janë të detyruar të respektojnë rregullat e sjelljes dhe parimet e parashikuara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.
7. QKTGJakut promovon dhurimin e gjakut si një akt vullnetar dhe pa shpërblim financiar, në përputhje me parimet e solidaritetit dhe interesit publik.
8. Institucioni garanton komunikim të qartë, transparent dhe të bazuar në informacion të saktë me qytetarët, dhuruesit, pacientët dhe publikun, me qëllim forcimin e besimit dhe ndërgjegjësimit shoqëror .
9. QKTGJakut duhet të mbrojë konfidencialitetin e informacionit që mund të sjellë dëme për individin ose komunitetin nëse bëhet publik. Përjashtimet mund të justifikoen mbi bazat kur interesi publik mbizotëron mbi atë privat.
10. Veprimtaria e institucionit zhvillohet mbi bazën e parimeve të barazisë, përfshirjes dhe respektimit të diversitetit kulturor, social dhe njerëzor.
11. 12. QKTGJ promovon zhvillimin profesional të vazhdueshëm të punonjësve të saj, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
12. QKTGJakut dhe punonjësit e saj nxisin bashkëpunimin institucional dhe profesional me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në funksion të përmbushjes së misionit të institucionit dhe forcimit të besimit publik.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

KODI I ETIKËS

Baza ligjore

Ky Kod hartohet në zbatim të:

- Ligjin nr. 9739, datë 21.05.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- Në mbështetje të: Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,
- Ligjit Nr.9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar,
- Ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e profesioneve publike",
- , Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,
- VKM-së Nr.874,datë 29.9.2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të Etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike",
- Çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e shëndetit publik dhe administratës publike.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

a) Qëllimi i këtij Kodi është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për punojësit e QKTGJ, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në Fushën e Trasfuziologjisë si dhe me rregullat e etikës në Administratën Publike.

b) Rregullat e përcaktuara në këtë Kod do të zbatohen për të gjithë dhe nga të gjithë punonjësit gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksionit. Kudo që do të përmendet termi "punonjës", do të nënkuptohen punonjësit e të gjitha niveleve të strukturës organike të institucionit.

c) Rregullat e Kodit vendosin detyrime për punonjësit, duhet të angazhohen në promovimin, njohjen kuptimin e saktë dhe zbatimin korrekt të rregullave etike.

Neni 2
Misioni

Misioni kryesor i veprimtarisë së QKTGJ, konsiston në sigurimin e vazhdueshëm dhe të qendrueshëm të gjakut dhe komponentëve të tij, për të vënë në dispozicion të pacientëve gjak dhe komponentë të tij të sigurta dhe cilësore, të mbledhur nga dhurues vullnetarë të papaguar të gjakut.

Në përputhje me misionin, objektivat dhe funksionet institucionale të QKTGJ, çdo veprimtari e ushtruar nga punonjësit duhet të reflektojë përkushtim profesional.

standarte të larta të përgjegjshmërisë dhe respektimin korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim ruajtjen dhe forcimin e besimit tek publiku. Vetëm një performanc e një niveli të lartë në të gjitha drejtimet kontribon në krijimin e besimit dhe mbështetjes publike.

Ky Kod Etike mishëron vlerat etike në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë e çdo punonjësi të QKTGJ në përmbushjen të veprimtarisë së tyre.
Kodi nuk përmbanë përgjime ndaj të gjithave situatave apo dilemave etike që mund të hasen në praktikë. Ai synon të nxisë reagimet e duhura nga ana e punonjësve bazuar në parimet dhe drejtimet kryesore etike të përmbledhura në Kod. Ai përfaqëson gjithashu një angazhim të qartë për të përmbushur detyrat që lidhen me veprimtarinë e QKTGJ në një nivel të lartë profesional, në respekt të misionit që ka ky institucion.

Neni 3
PARIMET E PËRGJITHSHME

Bazuar në objektivat dhe misionin e QKTGJ, është shumë e rëndësishme që aktiviteti të ndërmerret në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme për të nxitur besimin tek publiku në përgjithësi.
Punonjësit e QKTGJ-së janë të detyruar të respektojnë dhe zbatojnë këto parime bazë:

1. Profesionalizmi, njohuritë dhe kompetenca në ushtrimin e funksioneve
2. Objektiviteti, paanshmëria, barazia dhe drejtësia në vendimmarrje dhe veprimtari
3. Integriteti, përgjegjshmëria dhe korrektësia etike në ushtrimin e detyrës
4. Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit dhe komunikimi etik e transparent me publikun dhe palët e interesuara
5. Paraqitje personle dhe respektimi i ambjentit të punës
6. Konflikt i interesit

KREU II

Neni 4
Njohuritë dhe Kompetenca

1. Punonjësit duhet të angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për rritjen dhe përditësimin e njohurive, aftësive dhe kapaciteteve profesionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe përmbushjen efektive të misionit institucional në shërbim të komunitetit.
2. Punonjësit janë të detyruar të ushtrojnë funksionet e tyre me profesionalizëm, integritet, ndershmëri dhe përgjegjshmëri, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi. Përfshirja aktive në veprimtari profesionale dhe trajnuese që synojnë zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësive profesionale konsiderohet element thelbësor për garantimin e standardeve të larta të shërbimit.
3. Punonjësit i nënshtrohen vlerësimit periodik të performancës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aftësitë, përvoja dhe kompetencat profesionale të fituara duhet të reflektohen në cilësinë, efektivitetin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ushtrimit të detyrave funksionale.

4. Punonjësit duhet të respektojnë dhe zbatojnë me korrektësi legjislacionin në fuqi, si dhe politikat, procedurat dhe strategjitë institucionale, duke mos penguar në asnjë rast realizimin e objektivave dhe funksionimin normal të institucionit.
5. Punonjësit duhet të ruajnë marrëdhënie profesionale dhe etike me eprorët, kolegët dhe vartësit, në respekt të hierarkisë administrative dhe në funksion të bashkëpunimit institucional, realizimit të objektivave të përbashkëta dhe garantimit të një mjedisi pune korrekt e profesional

KREU III
MIRËSJELLJA, VESHJA DHE SIGURIA NË PUNË

Neni 5
Komunikimi dhe Sjellja

1. Punonjësit e QKTGJ-së duhet të respektojnë standardet e etikës profesionale, mirësjelljes dhe korrektësisë në marrëdhëniet me dhuruesit e gjakut, qytetarët, kolegët, eprorët dhe bashkëpunëtorët institucionalë, duke garantuar një komunikim profesional dhe etik

1.1 Komunikimi ndërmjet punonjësve të QKTGJ-së duhet të karakterizohet nga etika profesionale, respekti reciprok, bashkëpunimi institucional, korrektësia, transparenca dhe ndershmëria.

1.2 Komunikimi verbal dhe joverbal (gjuha e trupit, gjestikulacioni, toni i zërit, mënyra e komunikimit, mënyra e vështrimit, ruajtja e distancës fizike dhe sjelljes profesionale) duhet të jetë korrekt, i qartë dhe pa elemente fyese, diskriminuese apo stigmatizuese, për çfarëdolloj arsyen apo shkaku, duhet të jetë korrekt, etik i përshtatshëm, i matur dhe pa përdorur gjuhë fyese, diskriminuese apo paragjykuese.

1.3 Në ambientet e QKTGJ-së ndalohet përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme, komunikimi agresiv apo çdo formë sjelljeje që cenon etikën profesionale dhe marrëdhëniet institucionale.

1.4 Punonjësit nuk duhet të tolerojnë apo të ushtrojnë asnjë formë diskriminimi apo ngacmimi, bazuar në gjini, racë, besim fetar, kombësi, etni, status social, gjendje shëndetësore apo çdo kriter tjetër të mbrojtur me ligj.

1.5 Punonjësit e QKTGJ-së në proocesin e komunikimit dhe vendim-marrjes duhet të respektojnë në parim hierarkin instituconale.

1.6 Përdorimi i telefonit celular për qëllime personale lejohet vetëm nëse nuk pengon kryerjen e detyrave funksionale. Përdorimi i tij gjatë takimeve dhe mbledhjeve të punës është i ndaluar, përveç rasteve të justifikuara.

Neni 6
Veshja dhe Paraqitja e Jashtme

a) Punonjësit e QKTGJ-së duhet të mbajnë një paraqitje të rregullt, profesionale dhe dinjitoze në përputhje me funksionin publik, etikën institucionale dhe standardet e sigurisë në punë, si dhe duhet të përmbushë standartet e profesionalizmit dhe modestisë. Veshja duhet të jetë serioze, e përshtatshme me ambientin e punës dhe të kontribuojë në ruajtjen e imazhit, besueshmërisë dhe integritetit të institucionit.

duke shmangur kështu krijimin e përshtypjes së pahishijshme dhe dëmtimin e imazhit të Istitucionit.

b) Çdo punonjës i QKTGJ-së duhet të respektojë standardet e higjienës personale dhe profesionale, duke garantuar pastërtinë, kujdesin personal dhe paraqitjen e përshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës funksionale.

c) Në ambientet e QKTGJ-së nuk lejohen veshje apo paraqitje që bien ndesh me etikën profesionale dhe seriozitetin institucional, përfshirë veshjet tepër ekstravagante, të papërshtatshme ose që cenojnë standardet e profesionalizmit.

Respektimi i rregullave të higjienës dhe sigurisë në punë është detyrim i çdo punonjësi.

Neni 7

Ndalimi i Konsumimit të Alkoolit, Duhanit dhe Substancave të Ndaluara

a) Në ambientet e QKTGJ-së ndalohet konsumimi, posedimi apo paraqitja nën efektin e pijeve alkoolike, substancave narkotike apo çdo substance tjetër që cenon aftësinë për kryerjen e detyrës dhe sigurinë në punë.

b) Ndalohet pirja e duhanit në ambientet e brendshme të institucionit, laboratorëve, ambienteve të ruajtjes së gjakut dhe përbërësve të tij, si dhe në çdo hapësirë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e brendshme të QKTGJ-së.

c) Çdo shkelje e dispozitave të këtij neni përbën shkelje disiplinore dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

KONFLIKTET E INTERESAVE

Neni 8

Shmangia e Konfliktit të Interesit

Punonjësit e qktgj duhet të njohin dhe të zbatojnë me korrektësi detyrimet e kuadrit ligjor që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrave të tyre. Ata duhet të garantojnë mbrojtjen e iteresit publik në të gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të kompromentojë itegritetin dhe besueshmërin e publikut, për të shmangur konfliktin e interesit dhe rrezikun e përdorimit të gabuar të informacionit, është e nevojshme që punonjësit të këshillohen me drejtuesit.

a) Punonjësit e QKTGJ-së duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri, integritet dhe profesionalizëm, duke shmangur çdo situatë që krijon ose ku interesat private bien ndesh me detyrën publike.

- Punonjësit nuk duhet të përdorin pozicionin, informacionin apo autoritetin e tyre për përfitime personale apo në favor të palëve të treta. Çdo konflikt interesi duhet të deklarohet menjëherë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të institucionit.

- Shmangia, deklarimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe aktet e brendshme të QKTGJ-së.

b) Punonjësit e QKTGJ kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, veprimtari sindikale, akademike, trajnuese apo shkencore, për aq kohë sa këto veprimtari nuk cenojnë paanshmërinë, etikën institucionale dhe realizimin korrekt të detyrave funksionale.

Pjesëmarrja në këto veprimtari nuk duhet të ndikojë në performancën në punë, në reputacionin e institucionit apo në respektimin e rregullave të konfidencialitetit dhe etikës profesionale.

Punonjësit e QKTGJ kanë detyrim të përmbushin çdo kërkes tjetër sipas parashikimeve përkatëse të Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2005, "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funkdioneve publike*" *i ndryshuar.*

KREU IV
KONFIDENCIALITETI, MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE E DREJTA E AUTORIT

Neni 9
Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave

a) Punonjësit e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe dokumentacionit zyrtar që administrojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligjinr.119/2014 " për të drejtën e informiomit"i ndryshuar me ligjin nr. 78/2023 datë 21.09.2023

b) Punonjësit e QKTGJ-së duhet të garantojnë ruajtjen, administrimin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale bazuar mbi LIGJ Nr. 124/2024 " për mbrojtjen e të dhënave personale.

c) Ndalohet përdorimi, shpërndarja apo publikimi i informacionit konfidencial për interesa personale, përfitime të paligjshme ose për qëllime që cenojnë interesin publik, reputacionin dhe veprimtarinë e QKTGJ-së.

d) Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me QKTGJ, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Punojësit e QKTGJ pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdorin informacionin konfidencial të marra gjatë kryerjes së detyrës për interesa personal.

e) Publikimi i të dhënave lejohet vetëm kur kërkohet nga ligji ose në formë të agreguar, pa cenuar identitetin e individëve.

Neni 10
Marrëdhëniet me Median dhe Publikimet Publike

a) Punonjësit e QKTGJ-së duhet të mbajnë një qëndrim etik, profesional dhe institucional në komunikimet publike, duke shmangur çdo deklaratë, publikim apo veprim që mund të dëmtojë imazhin, besueshmërinë dhe integritetin e institucionit.

b) Çdo komunikim zyrtar me median, rrjetet sociale apo publikun mbi veprimtarinë e QKTGJ-së kryhet vetëm nga personat e autorizuar, në përputhje me kompetencat dhe aktet e brendshme të institucionit, duke garantuar transparencë, saktësi dhe interes publik.

c) Punonjësit e QKTGJ-së mund të kontribuojnë në publikime shkencore, edukative ose informuese në fushën e transfuzionit të gjakut, sigurisë së gjakut, duke respektuar etikën profesionale, konfidencialitetin dhe interesin institucional.
d) Ndalohet publikimi ose shpërndarja e informacioneve të brendshme, dokumenteve institucionale apo të dhënave sensitive pa miratimin paraprak të strukturave përgjegjëse të QKTGJ-së.

KREU V
DHURATAT, FAVORET DHE PËRFITIMET E TJERA
Neni 11

a) Punonjësit e QKTGJ-së nuk duhet të kërkojnë, të pranojnë apo të përfitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për vete, familjarët, të afërmit apo persona të tretë, dhurata, favore, pritje, shërbime, premtime apo çdo përfitim tjetër, kur këto lidhen me detyrën, funksionin ose pozicionin e tyre zyrtar.

b) Ndalohet pranimi i çdo dhurate apo favori që mund të ndikojë, ose të krijojë përshtypjen se ndikon, në paanshmërinë, objektivitetin, integritetin, shpërblim për vendimmarrje dhe mënyrën e kryerjes së detyrës nga punonjësi i QKTGJ-së.

c) Punonjësit e QKTGJ-së nuk duhet të kërkojnë, të japin apo të ndërmjetësojnë dhurata për punonjës të tjerë, eprorë, vartës apo persona të lidhur me ta, për shkak të marrëdhënieve zyrtare, hierarkike apo funksionale.

d) Mund të pranohen vetëm dhurata simbolike me karakter protokollar protokollar ose institucional, të dhëna në kuadër të marrëdhënieve institucionale, bashkëpunimeve me organizata kombëtare apo ndërkombëtare, aktiviteteve shkencore, trajnuese ose promovuese, me kusht që ato të mos cenojnë objektivitetin, paanshmërinë dhe imazhin e QKTGJ-së.

e) Dhuratat e lejueshme, me vlerë simbolike, mund të mbahen nga punonjësi vetëm kur nuk tejkalojnë kufirin e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nuk krijojnë konflikt interesi.

f) Në asnjë rast nuk lejohet pranimi i dhuratave në para, shpërblimeve monetare, favoreve ekonomike apo çdo përfitimi tjetër që lidhet me ushtrimin e detyrës, veçanërisht nga subjekte që kanë marrëdhënie kontraktore, procedura prokurimi, autorizime, kërkesa apo interesa të drejtpërdrejta me QKTGJ-në.

KREU VI
KOHA E PUNËS DHE MASAT DISIPLINORE
Neni 12
Koha e Punës

a) Punonjësit e QKTGJ-së respektojnë orarin zyrtar të punës dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën individuale dhe rregulloret e brendshme, me përjashtim të rasteve kur për arsye objektive autorizohet ndryshe nga titullari i institucionit.

b) Koha e punës përdoret në mënyrë efektive dhe vetëm për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Pjesëmarrja në aktivitete jashtë institucionit (trajnime, konferenca, takime) realizohet me miratim paraprak dhe sipas procedurave zyrtare.

Neni 13

Masat Disiplinore

a) Punonjësit e QKTGJ-së që shkelin parime e etikës të përcaktuara në këtë kod etike, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore sipas procedurës së përcaktuar me legjislacionin për statusin e nënpunësit civil.

b) Punonjësit e QKTGJ-së që thyejne disipinën në punë ndëshkohen me këto masa sipas Kodit të Punës:
   - Terheqje Vemendje
   - Vërejtje me Shkrim
   - Verejtje me paralajmërim për pushim nga puna
   - Zbritje ne detyre ne nje cikel me te ulet per nje perjudhe deri ne nje vit.
   - Pushim nga puna dhe zgjithje e kontrates

c) Çdo shkelje ose thyrje të disiplinës në punë kuptojmë largimin pa leje për punë personale gjatë orarit të punës, ose krijon dëm ekonomik si rezultat i mungesave në punë.

Neni 14

Zbatimi

a) Për zbatimin efektiv të këtij Kodi Etike, QKTGJ merr të gjitha masat e nevojshme për njohjen, publikimin dhe zbatimin e tij, përfshirë publikimin në faqen zyrtare të institucionit dhe shpërndarjen tek çdo punonjës.

b) QKTGJ garanton ngritjen e mekanizmave të brendshëm për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Kodi.

c) Çdo shkelje e dispozitave të këtij Kodi trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe të drejtës për një proçes të rregullt disiplinor.

Neni 15

Hyrja në Fuqi

a) Ky Kod Etike hyn në fuqi në përputhje me rregulloren e brendshme që mund të ndryshojë në të ardhmen, sipas nevojave dhe iteresave të shprehura nga palët e iteresuara dhe me miratimit nga drejtori i QKTGJ-së dhe zbatohet për të gjithë punonjësit e këtij Institucioni.

